



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2018-01

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 6 qershor 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për Caktimin e Gjykatëses së Vetme

Gjykatëses së Vetme:

Gjykatëse Marzhori Masëlo

Prokurores së Specializuar:

Kimberli P. Uest

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara ("Kryetarja"), duke vepruar në bazë të nenit 33(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), rregullave 82(4), 85(1) dhe 86(1) dhe (2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja") dhe rregullave 3 deri në 5 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë ("Rregullorja për Caktimin"), me anë të këtij vendimi cakton Gjykatësen e Procedurës Paraprake.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 29 maj 2018, Ushtruesi i Detyrës së Prokurorit të Specializuar i kërkoi Kryetares të caktonte Gjykatësin e Vetëm në bazë të nenit 33(2) të Ligjit.
2. Më 29 maj 2018, Kryetarja caktoi Gjykatësin Nikola Giju si Gjykatës të Vetëm.¹
3. Më 6 qershor 2024, Gjykatësi Giju dha dorëheqjen nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë, me efekt të menjëhershëm.

II. CAKTIMI

4. Në përputhje me rregullën 5 të Rregullores për Caktimin, Kryetarja duhet të caktojë një Gjykatës të Ri Paraprak për të zëvendësuar Gjykatësin Giju, duke marrë parasysh kriteret e përcaktuara në rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin, në veçanti përvojën dhe kompetencën përkatëse si edhe disponueshmërinë në këtë moment.

¹ KSCPR-2018/F00004, Vendim për Caktimin e një Gjykatësi të Vetëm sipas nenit 33(2) të Ligjit, 29 maj 2018 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*).

PËR KËTO ARSYE, KRYETARJA ÇAKTON

Gjykatësen Marzhori Masëlo

Si Gjykatëse të Vetme në procesin aktual.

____/nënshkrimi/____

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,

Kryetare e Dhomave të Specializuara

E enjte, 6 qershor 2024

Në Hagë,

Holandë